



| | | | |
|---|------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery | 31. 03 2023 | 3 viti god year | |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKANSACK | 3217/2023 | | 1/6 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.360/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.360/2023 të datës 15.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 30.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. ~~Aprovohet si e bazuar~~ ankesa A.nr.360/2023 e datës 15.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari i Vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2023 për ankuesen lidhur me notën e përgjithshme vlerësimit nga nota mjaftueshëm (2.3) në notën e përgjithshme mirë (2.6).
- III. Ky vendim zëvendëson formularin si pikën II dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale të ankueses dhe në regjistrat përkatës të nëpunësve civil.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Birimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 15.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolloi 1757/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, me pretendimin së vlerësimi përfundimtar i punës është jo real dhe subjektiv.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa, Këshilli me datë 09.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas kontaktimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolloi 1757/2023 të datës 15.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 19.08.2022 nga ankuesja për KPMSHCK-në; E-mailin e datës 17.08.2022 dhe 16.08.2022 nga M.L; E-mailin e datës 16.08.2022 nga I.M; E-mailin e datës 08.02.2022 nga ankuesja për Xh.R; E-mailin e datës 08.02.2023 nga ankuesja për H.Zh dhe H.D; E-mailin e datës 10.02.2022 nga ankuesja për M.A; E-mailin e datës 10.02.2022 nga M.L për V.K dhe D.Gj; E-mailin e datës 10.02.2022 nga F.M për ankuesen; E-mailin e datës 10.02.2022 nga I.B për D.Gj dhe M.L; E-mailin e datës 01.02.2022 nga V.B; E-mailin e datës 08.02.2022 nga D.R; E-mailin e datës 08.02.2022 nga ankuesja për N.Sh; E-mailin e datës 02.02.2022, 07.02.2022 nga H.Zh; E-mailin e datës 16.03.2022 nga ankuesja për L.K; E-mailin e datës 28.02.2022 nga L.K; E-mailin e datës 09.03.2022 nga ankuesja për S.J; E-mailin e datës 07.03.2022 nga ankuesja për N.G; E-mailin e datës 07.03.2022 nga ankuesja për F.P dhe Gj.M; E-mailin e datës 03.30.2022 nga ankuesja për F.B; E-mailin e datës 01.03.2022 nga H.Zh; E-mailin e datës 28.02.2022 nga ankuesja për N.N; E-mailin e datës 12.08.2022 nga ankuesja për N.B; E-mailin e datës 09.08.2022 nga G.K; E-mailin e datës 01.08.2022 nga K.C; E-mailin e datës 12.08.2022 nga ankuesja për H.Zh; E-mailin e datës 12.08.2022 nga R.Q për G.K; E-mailin e datës 11.08.2022 nga ankuesja për A.E; E-mailin e datës 27.06.2022, 02.06.2022 nga ankuesja për L.K; E-mailin e datës 19.08.2022 nga ankuesja për H.Zh dhe M.L; E-mailin e datës 19.01.2023 nga ankuesja për F.S; Vendimin me numër protokolloi 4614/22 i datës 16.08.2022 për emërimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Inspektoratit të Mjedisit, Urjave Natyrës, Planifikimit Hapësinor; Lista e ankesave; Përgjigjen në ankesë me numër protokolloi 3730-3/22 e datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolloi 3711-4/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 4312-4/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 4113-3/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 3708-4/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 3710-4/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 3691-4/22 e datës 11.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolloi 1902-5/22 e datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolloi 7625-3/22 e datës 13.01.2023; Vendimin me numër protokolloi 6512-3/22 të datës 30.11.2022; Vendimin me

numër protokolli 6918-2/22 të datës 10.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3378-3/22 e datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5402-3/22 të datës 01.11.2022; Vendimin me numër protokolli 5377-3/22 të datës 13.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5934-3/22 të datës 31.10.2022; Vendimi me numër protokolli 5935-2/22 të datës 31.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5401-3/22 të datës 31.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5430-3/22 të datës 31.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5818-2/22 të datës 31.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6551-4/22 të datës 05.12.2022; Vendimin me numër protokolli 6552-4/22 i datës 02.12.2022; Vendimin me numër protokolli 6924-3/22 i datës 25.12.2022; Vendimin me numër protokolli 5503-3/22 i datës 13.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5827-3/22 e datës 11.11.2022; Vendimin me numër protokolli 5320-1/22 i datës 11.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7972/22 e datës 20.01.2023; Vendimin me numër protokolli 7256-2/22 i datës 20.12.2022; Vendimin me numër protokolli 6559-4/22 i datës 05.12.2022; Vendimin me numër protokolli 4113-3/22 i datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolli 4115-3/22 i datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolli 4116-4/22 i datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6922-3/22 i datës 21.12.2022; Vendimin me numër protokolli 6388-2/22 i datës 25.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6221-3/22 i datës 11.11.2022; Vendimin me numër protokolli 6471/22 i datës 21.11.2022; Vendimin me numër protokolli 6472-3/22 i datës 21.11.2022; Vendimin me numër protokolli 4427-3/22 i datës 13.10.2022; Vendimin me numër protokolli 4491-4/22 i datës 11.10.2022; Vendimin me numër protokolli 5400-3/22 i datës 25.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6096-3/22 i datës 11.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7197-2/22 i datës 21.12.2022; Vendimin me numër protokolli 5431-2/22 i datës 31.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6712-4/22 i datës 05.12.2022; Vendimin me numër protokolli 5819-3/22 i datës 25.10.2022; Vendimin me numër protokolli 6463-3/22 i datës 12.12.2022; Vendimin me numër protokolli 6711-3/22 i datës 30.11.2022; Vendimin me numër protokolli 4115-3/22 i datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 6778-3/22 të datës 11.11.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 6279-2/22 e datës 11.11.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3378-3/22 e datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3378-3/22 e datës 11.10.2022; Vendimin me Nr.2297/2016 i datës 10.05.2016; Vendimin me numër protokolli 1889 i datës 09.03.2022; Vendimin me numër protokolli 2435 i datës 29.03.2022; Vendimin me numër protokolli 2434 i datës 29.03.2022; Vendimin me numër protokolli 4345 i datës 09.06.2022; Vendimin me numër protokolli 5650 i datës 10.08.2022; Vendimin me numër protokolli 5649 i datës 10.08.2022; Vendimin me numër protokolli 6224 i datës 14.09.2022; Vendimin me numër protokolli 6223 i datës 14.09.2022; Vendimin me numër protokolli i 6543 i datës 29.09.2022; Vendimin me numër protokolli 6542 i datës 29.09.2022; Vendimin me numër protokolli 7517 i datës 03.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7516 i datës 03.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7515 i datës 03.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7590 i datës 07.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7591 i datës 07.11.2022; Vendimin me numër protokolli 7592 i datës 07.11.2022; Vendimin me numër protokolli 920 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 996 i datës 04.02.2022; Vendimin me numër protokolli 935 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 940 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 929 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 928 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 937 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 926 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 939 i datës 02.02.2022; Vendimin me numër protokolli 1536 i

datës 24.02.2022; Vendimin me numër protokolli 995 i datës 04.02.2022; Emailin e datës 03.02.2023 nga A.M; Emailin e datës 16.08.2022, 31.01.2023 nga ankuesja për S.J; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 i datës 31.01.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2113/2023 e datës 24.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2518/2023 e datës 09.03.2023; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimi i datës 11.09.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitë Zyrtar i Lartë për Koordinim të Politikave; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen shtator-dhjetor 2019 i darës 26.12.2019; E-mailin e datës 06.03.2023, 27.02.2023 nga L.O për S.J; Emailin e datës 09.03.2022 nga S.J për L.O; Emailin e datës 08.12.2022 nga ankuesja për S.J dhe H.Zh; E-mailin e datës 08.12.2022 nga S.J për H.Zh; E-mailin e datës 04.03.2022, 07.12.2022 nga S.J për ankuesen; Emailin e datës 04.03.2022, 07.03.2022 nga ankuesja për S.J; E-mailin e datës 02.09.2021, 13.12.2019 nga S.J për ankuesen; Raporti javor i Divizionit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave i datës 17.11.2022, 11.11.2022, 02.12.2022, 09.12.2022, 16.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankueses, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe se e njëjta sipas Aktit të Emërimit të datës 11.09.2014 ushtron pozitën e punës *Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave*, në Divizionin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Me tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Udhëheqësja e Divizionit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejt të ankueses, me datë 31.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme 2.3.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punës dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Shton së vlerësimi është jo i drejt dhe subjektiv dhe së e njëjta përpos punëve në Divizionin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave ka qenë e angazhuar në komisione punese të ministrisë.

Kolegji në kuptim të vendosjes meritorë ju referuar nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: *1.Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo*

institucionit..... dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues..,

Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës, nga dhe ka konstatuar së ankuesja nuk posedon plan individual të objektivave të punës, të përcaktuara në fillim vit dhe në bashkëpunim mes mbikëqyrësit dhe ankueses. Me tej, nga provat e çështjes rezulton së ankuesja nuk ka ofruar asnjë raport të punës për vitin 2022 lidhur me kryerjen dhe realizimin e detyrave të punës sipas Aktit të Emërimit, gjegjësh për pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave, fakt ky i pohuar edhe nga ankuesja përmes emalit të datës 08.12.2023 drejtuar mbikëqyrëses se saj ku konfirmon " se me gjithë respektin dhe dëshirën për punë në DIEKP, jo vetëm që jam e angazhuar në grupe punuese dhe udhëzime administratave por Sekretari i Përgjithshëm më ka angazhuar edhe si Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të ushtuar kundër Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave Natyrës dhe Planifikimin Hapësinor... nuk po më mundëson kohë dhe mundësi të merrem me punë të DIEKP. Mirëpo bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar së ankuesja ka qenë e angazhuar në disa komisione dhe grupe punuese të cilat angazhime sipas vlerësimit të Kolegjit edhe pse nuk hynë në fushëveprimin e punës së Divizionit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, janë me interes të përmbushjes së objektivave të përgjithshme të institucionit, fakt relevant për vendosje lidhur me këtë çështje juridike.

Kolegji duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 25 dhe 26 konstaton së Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike. Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit


Bazuar në të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: "Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor , vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)" ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesen, ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare dy pikë tre (2.3), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare dy pikë gjashtë (2.6), e që në kuptim të nenin 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe paragrafin 2 nënparagrafin 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin "mirë".

Theksuar si më sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.360/2023

Avdyll BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.